

SHPALLJE

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË KATEGORISË SË LARTË DREJTUESE NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË OSE PRANIMIT NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut III, IV dhe VIII të Vendimit Nr. 118, datë 05/03/2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, Bashkia Elbasan, shpall procedurat e ngritjes në detyrë ose pranimit nga jashtë në shërbimin civil për pozicionin:

1. Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Infrastrukturore Kategoria e pages II-a

Pozicioni më sipër, është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë si dhe për persona të tjerë jashtë shërbimit civil të cilët përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Për të dy procedurat (ngritje në detyrë ose pranim nga jashtë në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për - **NGRITJE NE DETYRE DHE PRANIM NGA JASHTE:**
16 Mars 2019

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si me sipër është:

- Është përgjegjës për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave bashkiake në fushën e shërbimeve të territorit urban, rrjetit rrugor, trafikut, emergjencat civile, menaxhimit të territorit në zbatim të misionit dhe prioritetëve strategjike të miratuara të Bashkisë.
- Orienton strukturat në varësi të tij në bashkërendimin e punëve ndërmjet tyre dhe merr masat e nevojshme për sigurimin e këtij bashkëpunimi.
- Zgjidh konfliktet e kompetencave ndërmjet strukturave apo punonjësve në vartesi, në rast mosrealizimi i relation çështjen Kryetarit të Bashkisë i cili vendos me akte të veçanta.
- Merr dhe shpërndan korespondencën ditore duke bërë adresimet për ndjeke me detyra specifike sipas rasteve.
- Kontrollon, monitoron dhe verifikon kryerjen e funksioneve të sektorëve e specialistëve të drejtorive që mbulon në përputhje me zbatimin e akteve ligjore e nënligjore përkatëse.
- Merr pjesë në hartimin e planeve dhe analizave vjetore të punës të drejtorive duke planizuar përmbushjen e funksioneve sipas planit të Bashkisë.
- Miraton planet e punës mujore të drejtorive për përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga planet vjetore dhe ato që dalin gjatë dinamikës së punës.

- Kontrollon e miraton materialet që përgatiten nga drejtoritë për Këshillin Bashkiak .

1. NGRITJA NE DETYRE DHE PRANIMI NGA JASHTE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR NGRITJEN NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-b)
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”
- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:
 - a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e Shkencave Ekonomike /Juridike ose Inxhinierike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë e së njëjtës fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
 - b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në Administratën Publike.
 - c) Të kenë aftësi të drejtimit strategjik, ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale, Efektivitet, integritet etj.
 - d) Të kenë njohuri të përdorimit të programeve bazë kompjuterike.
 - e) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
 - f) Të kenë njohuri të gjuhës angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
 - g) Të kenë njohuri të legjislacionit europian

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) Fotokopje të diplomës dhe e listës së notave e noterizuar;
- c) Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- ç) Fotokopje të librezës së punës e noterizuar;
- d) Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;

e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.03.2019 në Bashkinë Elbasan me adresë: Rr.Qemal Stafa

1.3 REZULTATET PER FAZEN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Ne datën **26.03.2019** Njesia Pergjegjese e Bashkise Elbasan do te shpalle ne faqen zyrtare te Bashkise Elbasan dhe ne portalin “Sherbimi Kombetar i Punesimit”, listen e kandidatave qe plotesojne kushtet dhe kerkesat e posaçme per proceduren e ngritjes ne detyre dhe pranimit nga jashte si dhe daten, vendin dhe oren e sakte ku do te zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Ne te njejten date kandidatet qe nuk i plotesojne kushtet dhe kriteret e vecanta per kete procedure do te njoftohen individualisht ne menyre elektronike nga njesia pergjegjese, per shkaqet e moskualifikimit (nepermjet adreses se e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA:

Kandidatët do të testohen me shkrim ne lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- dh) Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Per Transportet Rrugore”, i ndryshuar;
- e) Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- f) Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Per Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar;
- g) Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- gj) Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile"
- h) VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore"

Kandidatët gjate intervistes se strukturuar me goje do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite, aftesite, kompetencat ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes;
- b. Eksperiencon e tyre te meparshme
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmerite e tyre per karrieren.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 50 pikë;

- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 10 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia Përgjegjëse do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar I Punësimit”. Te gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil ose pranimin nga jashtë do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve:
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi duke filluar **nga 26.03.2019**